



## **Projekti: “EDUKIMI PUBLIK MBI DHUNËN NË SHKOLLA|”**

### **Projekti i Realizuar nga Qendra Psikologjike APONIA, në mbështetje nga Ambasada Amerikane Në Prishtinë**

**Periudha mars – dhjetor, 2015**



"This project was funded through a U.S. Embassy, Pristina grant. The opinions, findings, and conclusions or recommendations expressed herein are those of the Author(s) and do not necessarily reflect those of the Department of State."

"Ky projekt u financua përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit."

"Ovaj projekat je finansiran preko granta Američke Ambasade u Pristini. Mišljenja, stavovi i zaključci ili preporuke sadrzane ovde pripadaju autoru(ima) i ne izrazavaju neophodno stavove State Departmenta."

Dhjetor, 2015

## **Përmbajtja:**

Përmbledhje Ekzekutive.....	3
Hyrje.....	5
Qëllimi dhe Metodologjia.....	6
Prezantimi i rrezultateve.....	8
Prezantimi i pjesëmarrjes së nxënësve për çdo shkollë fillore të pilotuar.....	11
Shkolla i pjesëmarrjes së nxënësve për shkollat e mesme të pilotuara.....	16
Prezantimi i pjesëmarrjes së prindërve dhe mesimdhënësve.....	18
Punëtorët me nxënës të gjitha shkollave.....	20
Prezantimi i takimeve individuale të realizuara me nxënës.....	21
Rekomandimet.....	22

## Përmbledhje Ekzekutive

Raporti përmban të dhëna mbi projektin “Edukimi publik mbi dhunën në shkollë”, i cili është i mbështetur nga Ambasada Amerikane në Prishtinë - Republika e Kosovës, për periudhën kohore mars – dhjetor 2015. Shkollat e selektuara për realizim të projektit janë shtatë (7) shkolla në Komunën e Gjilanit; 5 shkolla fillore (dy shkolla fillore në fshatrat e Komunës së Gjilanit), dhe 2 shkolla të mesme. Shkollat pilot, janë: 1) Shkolla Fillore “Selami Hallaqi”, 2) Shkolla Fillore “Thimi Mitko”, 3) Shkolla Fillore “Sadullah Brestovci”, 4) Shkolla Fillore “Esat Berisha” në Llashticë, 5) Shkolla Fillore “Abdullah Tahiri” në Malishevë, 6) Shkolla e Mesme Teknike “Mehmet Isai”, dhe 7) Shkolla e Mesme Ekonomike “Marin Barleti”;

Dhuna në shkolla, është një prej problemeve shumë të përfolura në opinionin publik, në hapësirat jashtëshkollore dhe në shoqërinë tonë në përgjithësi. Përkundër strategjive të aprovuara kundër dukurisë së dhunës në shkolla, kjo çështje në shkollat tona mbetet shqetësuese. Bartësit e roleve të rëndësishme karshi edukimit të fëmijëve dhe të rinjëve në veçanti duket sikur më shumë rëndësi po i japim formaliteteve apo, problemet në shkolla trajtohen në mënyrë të përgjithësuar, pa u ndalur në përmbajtjen e problemit. Shpeshherë ndodh që të pyesim nxënësit se ç’far nota kanë, kush mëson më së miri në klase, duke e konsideruar këto si një nga treguesit për nivelin e nxënësit, duke anashkaluar vlerësimin për ndjenjat, emocionet e vet nxënësit, për shoqërinë, klasën, shkollën. Kështu vazhdojmë dhe mësohemi se ndjenjat janë personale, private, dhe pak ose aspak nuk i ndajmë me të tjerët. Në rastet kur vendosim t’i ndajmë emocionet me të tjerët sikur edhe me vështirësi pranohe mi nga të tjerët, pikërisht për shkak se mendojmë se po i ndajmë gjërat tona private, siç janë emocionet. Por, kur emocionet tona duhet të ndahen për shkak të nxitësve apo sepse ngacmohemi nga ndonjë situatë, që mund të jetë faktor i rëndësishëm për ne, reagimet tona dijnë të jenë më intensive e më të theksuara duke e vështirësuar edhe mëtej pranueshmërinë nga të tjerët. Sidomos kur flasim për fëmijët dhe të rinjtë të cilët ndjeshmëritë dhe reagimet i kanë më të shpejta dhe më të drejpërdrejta, shpeshherë pa menduar edhe për pasojat.

Diskutimi publik me karakter edukimi për parandalim të formave të ndryshme të dhunës është edhe më pak i prekun në Kosovë, përderisa në vende të ndryshme të botës, si në shkolla poashtu edhe në vende publike dhe ato private, zhvillohen programe nëpërmjet të cilave të rinjtë mësojnë dhe bëhen pjesë aktive e parandalimit të dhunës dhe sjelljeve të dhunshme në mejdiset ku ata janë.

Ky raport, përmban të dhëna për punën me nxënës nga 7 shkollat e përzgjedhura në komunën e Gjilanit, me participim të 5 shkollave fillore dhe dy shkollave të mesme. Dy nga shkollat janë në fshatra dhe të tjerat janë në pjesë të ndryshme të qytetit.

Pesë (5) psikologe të kontraktuara për realizimin e projektit kanë punuar me nxënës në grupe, përkatësisht nxënës me 10 takime të rregullta në shkollë, kane perfituar nga programi.

Nxënësit për këshillime individuale kanë qenë të lirë të zgjedhin sipas dëshirës apo nevojave që ata mund të kenë pasur për biseda të drejtëpërdrejta me psikologët. Të gjithë prindërit e nxënësve kanë qenë të informuar nëpërmjet shkresë informuese që është shpërndarë për secilin, për t'u bashkangjitur më vonë në takimet e përbashkëta me prindër, nxënës dhe mësues. Shkollat kanë qenë të përfaqësuara nga nxënësit, këshilli i shkollës, prindërit, mësuesit dhe drejtorët e shkollave gjatë takimit të përbashkët të mbajtur me karakter debati publik për dhunën në shkollë, për sjelljet e dhunshme apo agresive të nxënësve apo edhe të tjerëve. Dhe, në mënyrë të përmbledhur mund të thuhet se e gjithë infrastruktura që shkollat apo sistemi i arsimit në vendin tonë ka ofruar në çështjen e sigurisë si masë parandaluese e dhunës në shkollë ka qenë instalimi i kamerave të sigurisë, uniformat shkollore dhe rojet e shkollës. Ndërkaq, mësuesit pohojnë se masën më të shpeshtë që e përdorin për të mbajtur disiplinën në klasë është dënimi verbal dhe njoftimi i prindërve në rast se fëmija performon ndonjë sjellje që është kundër rregullave dhe rendit shtëpiak të shkollës. Përfundimisht, nxënësit, mësuesit dhe prindërit pajtohen që edukimi publik për parandalimin e sjelljeve agresive apo edhe të dhunshme në shkollat tona, ka nevojë për një intervenim të tillë apo çasje që është ofruar si rrjedhojë e realizimit të këtij projekti. Gjithashtu, sipas tyre, metodologjia e cila është ofruar përmes punës së drejtëpërdrejtë me nxënësit, është alternativ e nevojshme në ngritjen në nivel të mirë të funksionimit të trekëndëshit nxënës-prind-mësues.

## HYRJE

Gjendja e përgjithshme e shkollave në raport me dhunën mbase nuk është në nivelin e dëshirueshëm, duke ju referuar shkeljeve të rregullave, ngacmimeve, rrahjeve apo edhe të pranisë së armëve të ftohta gjë e cila paraqet shqetësim të madhë për shkollat. Përkundër programeve parandaluese që janë realizuar nëpër shkolla, sikur kanë qenë të pasinkronizuara midis institucioneve apo shpeshherë edhe të paplanifikuara mirë përbrenda shkollave. Funksionimi jo efektiv i organaneve të shkollave siç janë këshillat dhe aktivet, mund të kenë vështirësuar gjendjen në shkollat tona duke marrë parasysh edhe ngarkesën e shkollave me numër të madh të nxënësve dhe vështirësitë që ofron infrastrukturën jo adekuate e shkollave pjesëmarrëse në realizimin e projektit. Infrastruktura ligjore është punuar duke bazuar këtë fakt në rregulloret dhe strategjitë që institucionet përkatëse kanë punuar, si; Regullorja QRKNR. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar (MASHT, 2013), Strategjia për siguri në shkolla (MPB dhe MASHT, 2009). MINISTERIA e ARSIMIT e SHKENCËS dhe e TEKNOLOGJISË (MASHT) në bashkëpunim me organizatën Gjermane (GIZ), kanë nxjerrë për përdorim Sistemin për Menaxhim të Informatave në Arsim ( duke veçuar në sistemin EMIS - Education Management Information System), dhe rubrikën e veçant për raportimin e të gjitha formave të dhunës që mund të ndodhin në shkollë dhe që duhet të regjistrohen. Si i tillë, instrumenti mundëson gjithëpërfshirjen në mënyrë interaktive e të dhënave, përmes së cilit mundësohet kontrolli dhe transparenca, nëpërmjet ofrimit të një portofoli të gjerë për shkolla. Ky instrument, do të shërbej për të kontribuar në parandalimin e formave të ndryshme të dhunës, edhe të formave psikologjike në shkolla, sepse rastet e dhunës do të evidentoheshin të gjitha duke përkrahur të gjithë situatën dhe personat e përfshirë. Mirëpo, shkollat sikur janë mospërfillëse në raportimin e rasteve të dhunës, kur dihet se rastet të cilat ndodhin me karakter dhune në shkolla nuk i gjejmë të raportuara në këtë sistem. Kështu, personat e përfshirë, çiftë nxënës apo personel i shkollës mbeten të pa hetuar dhe të patrajtuar deri në fund për sjelljet apo veprimet e tyre, e për pasojë kjo ndikon që një pjesë e rasteve të dhunës apo sjelljeve të dhunshme të trajtohen deri në zgjidhjen e plotë të tyre.

## Qëllimi dhe Metodologjia

Periodha e pubertetit dhe adoleshences përfshinë nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme, si periudhë ku ndryshimet e mëdha ndodhin te fëmijët, duke kaluar nga të qenurit fëmijë në fëmijë të rinjë. Fëmijët rriten në aspektin psikofizik me ndryshimet hormonale të tyre. Përjetimet dhe eksperiencat e secilit nxënës janë individuale. Vështirësit dhe ndryshimet nëpër të cilat fëmijët kalojnë këtë periudhë të zhvillimit luajnë rol të rëndësishëm, varësisht nga stili i jetës dhe familja prej nga vjen secili prej tyre. Shkolla si një nga ambientet sociale për secilin nxënës i bënë ata të kenë ballafaqime dhe ngjashmëri të karakteristikave të caktuara. Sjelljet agresive si ato të dhunshme ndikohen, modelohen dhe përforcohen edhe në ambiente shkollore. Shpeshherë, ndodh që të rriturit (familja, mësimdhënësit) dijnë të jenë mospërfillës në raport me vlerësimin e emocioneve të vet fëmijëve, nxënësve. Si metodologji bashkëkohore për punë me nxënës, është përzgjedhur Manuali për menaxhim të zemërimit i implemetuar në punë me grupe nxënësish, me qëllim të çasjes së drejtpërdrejt me nxënës, përmes të cilit praktikisht nxënësit mësojnë shkathtësi të reja për menaxhim të zemërimit, sjelljeve agresive si një parakusht që të ulët niveli i sjelljeve të dhunshme në shkolla.

Qëllimi i realizimit të programit trajnues për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme është që të punohet me fëmijët me programin për “Menaxhim të zemërimit”<sup>1</sup>, përmbajtja e të cilit ka karakter edukues për nxënësit duke përfshirë dhe bashkëpunimin me mësimdhënësit dhe prindërit e tyre. Programi i aplikuar nëpërmjet punëtorive me nxënës, si aktivitete trajnuese për nxënës në grupe, është i aplikueshëm për të rinjtë e moshës 13 – 25 vjeçare. Përmbajtja e 10 takimeve të realizuara përmes punëtorive me nxënës, është e paraqitur në tabelë nr.1.

**Tabela nr.1. Prezantimi i çështjeve themelore nga manuali për menaxhim të zemërimit**

Takimi 1. Hyrje në program Dallimi midis zemërimit dhe agresivitetit	Vendosja e qëllimeve dhe rregullave të grupit
Takimi 2. Njohja e shkaqeve të zemërimit	Njohja e shkaqeve të zemërimit - vetëmonitorim
Takimi 3. Njohja e nxitësve	(mëso: çlirimin e avullit)
Takimi 4. Të drejtat dhe përgjegjësitë e zemërimit	Njohja e benefiteve dhe çmimit të zemërimit
Takimi 5. Hyrje në njohjen e komunikimit të sigurtë	Hyrje në njohjen e komunikimit të sigurtë
Takimi 6. Shkathtësitë e sigurta	Mëso teknikat e relaksimit
Takimi 7. Ndikimi i mendimeve tek emocionet	Përdorimi i vetë – bisedimi në menaxhim të zemërimit
Takimi 8. Reflektim mbi programin	Pregatitja e relapsit
Takimi 9. Stretëgjijtë e veprimit kundrejt zgjedhjes së problemeve	Zgjedhim probleme reale për diskutim
Takimi 10. Sistemi i referimit të rasteve të dhunës në shkolla	Njohja me akterët e nevojshëm si partner për bashkëpunim dhe referim për rastet e dhunës në shkolla

<sup>1</sup> Getting along and keeping cool: Center for Clinical Intervention in Collaboration with Youthlink, Western Australia, 2003

Në punëtorit e mbajtura, nxenesit kane perfituar nga permbajtja e takimeve duke mesuar per zemrimin si ndjenje, per nxitesit qe per pasoje kane reagimet e zemrimit, per metodat se si do te mund te menaxhonin situatat konfliktuoze duke mesuar njekoheisht edhe per teknika te relaksimit ne menyre qe te perballen me leht ne situata te tilla. Dy nga takimet e fundit kane pas karakter debati duke diskutuar rastet konkrete ne te cilat nxenesit mund te kene qene deshmitare te situatave konfliktuoze apo edhe te dhunshme ne shkolle apo rastet kur nxenesit kane qene inicues apo edhe viktime e rasteve dhe situatave konfliktuoze. Nxenesit gjithashtu kane bere kerkime per format e parandalimit te rasteve te dhunshme ne shkollat perkatese duke prezantuar nepermjet punimeve edhe hartimit te draftë dokumenteve per parandalim te dhunes ne shkolle. Dhe, pjese e permbajtjes se takimeve kane qene dhe njohja me apsketet procedurale te raportimit te dhunes ne shkolle duke u njohur njekoheisht edhe me institucionet pergjegjese per referim te rasteve te dhunes qe mund te ndodhin në shkolla.

Në çdo shkollë, përfitues me takime të rregullta dhe individuale, është përcaktuar që të jenë deri në 25 nxënës të cilët do të mësojnë teknika të reja për menaxhim të zemërimit, material ky i cili është përpunuar dhe është fasilutuar nga ekspertet.

Mësimdhënësit, prindërit dhe drejtorët e shkollave të pilotuara kanë qenë pjesë e fokus grupeve të vecanta të cilat jane realizuar në takime ku janë diskutuar shkaqet, nxitësit e sjelljeve agresive, raporti ndërmjet nxënësve dhe mësimdhënësve dhe anasjelltas si dhe raporti mesimdhënës dhe prindër, përkatësisht funksionimi i trekëndëshit pedagogjik (prind – mësimdhënës – nxënës) Fig 1. duke nxjerr dhe rekomandimet konkrete për parandalim të dhunës në shkolla.



**Fig 1. Trekëndëshi pedagogjik (prind – mësimdhënës – nxënës)**

## Prezantimi i rezultateve

Në të gjitha shkollat e pilotuara janë rreth 200 nxënës të cilët kanë përfituar mbi 14h të punës efektive për dhjetë ( 10) takime. Nga takimet individuale, janë rreth 84 nxënës (50 nxënës në 4 muajt e parë të projektit dhe rreth 34 nxënës nga muaji shtator deri në muajin tetor) që janë takuar. Poashtu në takimet e organizuara janë organizuar edhe fokus grupet me pjesëmarrje prej 70 personave, duke përfshirë pjesëmarrjen e prindërve dhe mësimeve të mësimdhënësve.

Pjesëmarrja e nxënësve nuk ka përfshirë pjesëmarrjen e plotë për 25 nxënës në një shkollë përkatëse për faktin se nxënësit nuk kanë qenë të detyruar të jenë pjesë e grupeve, mirëpo ata kanë qenë të njoftuar nëpërmjet drejtorive të shkollave dhe mësimeve të mësimdhënësve, dhe vendimi ka qenë i nxënësve për të marrë pjesë. Nxënësit fillimisht kanë hezituar të jenë pjesë e takimeve, duke e paragjykuar përbërjen e grupit ku në listën e nxënësve të përgatitur nga shkolla kanë qenë edhe nxënës me nota më të ulëta dhe me vijueshmëri jo të regullt në mësim duke ju referuar mungesave të nxënësve. Pjesëmarrja fillimisht ka qenë e ulët (shembull ilustrativ: pjesëmarrja nga takim i parë dhe i dytë; shembulli: Shkolla e Mesme Ekonomike “Marin Barleti”, nga 13 nxënës pjesëmarrës në takimin e parë duke rënë pjesëmarrja në 4 nxënës), mirëpo pjesëmarrja është rritur dhe ka vazhduar të jetë më stabile më pas kur nxënësit vet kanë gjykuar takimet duke i parë ato si të dobishme.

Nxënësit kanë paragjykuar pjesëmarrjen duke cituar: “ nuk dua të jem pjesë e barabartë me nxënësit problematik”, apo “nuk dua të jemë njëjtë me nxënësit e dobët”. Megjithatë, pas takimeve me drejtoritë e shkollave dhe mësimeve të mësimdhënësve, është rritur se takimet në grup me nxënësit kanë karakter trajnimi dhe trajtimi të problemeve të sjelljeve agresive dhe të dhunshme që mund të ndodhin në shkolla, ndërmjet nxënësve, mësimeve të mësimdhënësve dhe nxënësve apo edhe të trajtimit të nivelit të zemërimit që mund të reflektojnë te nxënësit në ambientet jashtëshkollore si p.sh. në shtëpi apo në rrethin social ku ata jetojnë.

Gjithashtu, vështirësitë janë paraqitur edhe për shkak të përfundimit të vitit akademik dhe ngarkesave të nxënësve me notimin përfundimtarë, prandaj edhe aktivitetet tjera në shkollë për ta kanë qenë të vështira për tu realizuar. Nga e gjithë kjo mund të thuhet se interesimi për pjesëmarrje është rritur nga deklaratimet e nxënësve pjesëmarrës për përmbajtjen e takimeve paraprake, gjë e cila ka ndihmuar gjithashtu në rritjen dhe përmirësimin e nivelit të gjykimeve të gabuara se takimet grupore janë të organizuara për nxënës problematik. Nxënësit kanë filluar shpejtë të akomodohen në takime grupore dhe kanë përmirësuar shpejt çasjen ndaj punësive të planifikuara për ta.

Fotografitë e prezantuara më poshtë, reflektojnë punën nga aktivitetet e takimeve grupore, formën dhe bashkëpunimin midis tyre si grupe përfaqësuese të shkollave.





### Realizimi i takimeve në grup me nxënës


Puna në grupe me nxënësit ka pasur karakter njohës dhe bashkëpunues duke përfshirë nxënësit e vullnetit të mirë për punë ekipore në adresim të dhunës në shkolla. Nxënësit të cilët kanë filluar me takime të rregullta, shpejt kanë kuptuar qëllimin e punëtorive, kanë përcaktuar orarin e takimeve, janë pajtuar me përmbajtjen dhe kohën e realizimit të takimeve të përbashkëta. Të facilituar nga ekspertet e kontraktuara, nxënësit janë familjarizuar me njëri tjetrin, kanë filluar të jenë pjesë aktive e përbërjes së grupit dhe vendosjes së objektivave të përbashkëta.



Nxënësit përmes punës së tyre në grupe përveç që kanë krijuar unifikimin e grupit, në bashkëpunim në mes vete (të ndarë në nëngrupe), kanë hulumtuar mbi gjendjen aktuale në shkollat ku ata mësojnë, kanë bashkëpunuar me organet e shkollës (drejtorinë e shkollës, mësimdhënësit) dhe njëkohësisht kanë debatuar mbi dukurinë e dhunës në shkollë dhe rrethin shoqëror të tyre. Përmes paraqitjes tabelare do të prezantohet pjesëmarrja e nxënësve në takime grupore, për të gjitha shkollat dhe shkollat në veçanti për dhjetë (10) takimet e planifikuara për çdo shkollë - grup nxënësish.

Pjesëmarrja e nxënësve në takimet e rregullta grupore										
Numri i takimeve	Takimi 1	Takimi 2	Takimi 3	Takimi 4	Takimi 5	Takimi 6	Takimi 7	Takimi 8	Takimi 9	Takimi 10
Selami Hallaqi	15	13	10	25	22	15	12	22	17	15
Thimi Mitko	18	21	11	8	23	16	13	9	13	9
Sadullah Brestovci	15	5	8	8	21	7	15	16	15	14
Abdullah Tahiri	9	19	22	21	22	24	25	19	15	16
Esat Berisha	1	14	15	15	18	9	25	18	21	25
Marin Barleti	11	10	17	12	22	11	17	24	17	18
Mehmet Isai	13	4	13	8	10	13	9	10	17	15
<b>Gjithsejt</b>	<b>96</b>	<b>86</b>	<b>96</b>	<b>97</b>	<b>138</b>	<b>95</b>	<b>116</b>	<b>118</b>	<b>105</b>	<b>112</b>

**Tabela nr. 1. Realizimi i takimeve grupore me nxënësit e shkollave të përzgjedhura**



Në takimet grupore, nxënësit kanë përfituar duke mësuar shkathësi sociale si;

1. Përmirësimi i bashkepunimit midis nxenesve;
2. Nxënësit kanë mësuar të vendosin qëllime dhe rregulla në grup;
3. Kanë mësuar të njohin agresivitetin, zemërimin dhe nxitësit e tyre;
4. Kanë mësuar shkathësi për vetëmonitorim të sjelljeve;
5. Kanë mësuar të njohin të tjerët, duke rritur mundësinë që të komunikojnë me të tjerët për probleme të njëjta;
6. Kanë mësuar se janë të njëjtë me të tjerët (me probleme të njëjta), duke qenë dhe të ndryshëm nga të tjerët;

7. Kanë mësuar që bashkëveprimi ndërmejt tyre, rritë mundësinë që të punojnë në parandalim të sjelljeve të dhunshme;
8. Nëpërmjet aktiviteteve përbrenda grupit, nxënësit kanë pasur mundësinë të njohin teknika të ndryshme të relaksimit të cilat mund t'i ushtrojnë dhe provojnë gjatë situatave të ndryshme, apo edhe përditshmërisë së tyre.

## **Prezantimi i pjesëmarrjes së nxënësve për çdo shkollë fillore të pilotuar**


Fillimisht duhet theksuar se në shtatë (7) shkolla të përzgjedhura për realizimin e këtij projekti, në të gjitha shkollat ( në 5 shkolla fillore dhe 2 shkollat e mesme), aktivitetet kanë qenë të njëjta në përmbajtje dhe kohë të realizimit si dhe në objektivat e vendosura paraprakisht. Aktivitetet e prezantuara në vijim, do të pasqyrojnë vijueshmërinë e nxënësve në takimet grupore të cilat dallojnë për nga numri i pjesëmarrësve.

Nxënësit në shkollën fillore “Selami Hallaqi”, kanë qenë bashkëpunues dhe aktiv, kryesisht pjesëmarrja e nxënësve në takime ka qenë e njëjtë. Drejtorja e shkollës ka përcjellë punën me nxënës duke ofruar ndihmë dhe mbështetje edhe nga pedagogu i shkollës. Pjesëmarrja e nxënësve ka qenë e niveleve të klasëve VII, VIII dhe IX. Mësimdhënësit kanë mirëkuptuar dhe ndihmuar nxënësit kur është kërkuar të lirohen dhe përgatisin prezantimet, detyra që i kanë marrë gjatë punës në nëngrupe të ndara për të kontribuar në diskutimet në grup për format e parandalimit të dhunës. Prindërit, gjithashtu janë njoftuar për punën me fëmijët e tyre në shkollë dhe disa nga prindërit kanë qenë të pranishëm në debatin e ftuar me prindër. Në takimet me prindërit, janë diskutuar situatat kur fëmijët mund të manifestojnë sjellje agresive, format e parandalimit të sjelljeve të dhunshme dhe theks i veçant i është vënë manualit për menaxhim të zemërimit, si një metodologji e avansuar dhe e dobishme për nxënësit, dhe vetë prindërit në raport me njohjen dhe mundësitë e parandalimit të agresivitetit të fëmijëve.

Në shkollën fillore “Selami Hallaqi”, pjesëmarrja e nxënësve do të prezantohet si në vijim:

**Tabela nr.3. Pjesëmarrja e nxënësve në takime grupore, sh.f.m.u „Selami Hallaqi“**

Nr.takimeve	Takimi 1	Takimi 2	Takimi 3	Takimi 4	Takimi 5	Takimi 6	Takimi 7	Takimi 8	Takimi 9	Takimi 10
Pjesëmarrja e nxënësve	15 nx.	13 nx.	10nx.	25 nx	22 nx.	15 nx	12 nx	22nx.	17 nx	15 nx
Datat:	1 prill	14 prill	21 prill	5 maj	13 maj	19 maj	2 qershor	6 tetor	12 tetor	19 tetor



Ndërës, në shkollën fillore "Thimi Mitko", me kërkesë të drejtorisë së shkollës aktivitetet kanë filluar më vonë për shkak të angazhimeve të nxënësve me aktivitete dhe projekte të tjera. Dallimi me nxënësit e shkollave të tjera nuk ka qenë i madh në kuptimin e interesimit për pjesëmarrje. Mbështetja e drejtorisë së shkollës dhe e mësimdhënësve të përfshirë në realizimin e aktiviteteve ka qenë e kënaqshme. Takimet janë realizuar në baza të rregullta, gjithmonë në pajtueshmëri me vullnetin dhe kohën e përcaktuar me nxënësit.

**Tabela nr.4. Pjesmarrja e nxenesve ne takime te rregullta ne sh.f.m.u. "Thimi Mitko"**

Numri I takimeve	Takimi 1	Takimi2	Takimi 3	Takimi 4	Takimi 5	Takimi 6	Takimi 7	Takimi 8	Takimi 9	Takimi 10
Thimi Mitko	21	18	11	8	23	8	23	16	13	9
Datat:	16 prill	20 prill	5 maj	22 maj	1 qershor	9shtator	1 tetor	2 tetor	12 tetor	16 tetor

Nxënësit përveç që kanë mësuar për format e menaxhimit të zemërimit, në bashkëpunim mes vete, kanë kontribuar duke dhënë opinionet e tyre për qasjen të cilën duhet të ketë shkolla në adresim të formave të parandalimit të sjelljeve të dhunshme dhe agresive gjatë procesit mësimor.




- a) Gjatë punës në takimet grupore me nxënës, janë diskutuar format e ndryshme të sjelljes agresive apo edhe të dhunshme të cilat manifestohen në shkollë në forma të ndryshme. Shumë nga mësimdhënësit deklarojnë se gjatë një viti shkollor ka ndodhur të paktën një herë ka ndodhur që nxënësi të jetë ofenduar nga shoku i klasës dhe që nxënësi të ketë reaguar me agresivitet ndaj shokut në klasë;
- b) Brenda një viti shkollor, ka ndodhur që një nxënës të ketë ofenduar një mësimdhënës, apo ky i fundit të ketë ofenduar rëndë një nxënës;
- c) Mësimdhënësit deklarohen se nuk preferojnë përdorimin e dhunës fizike duke u shprehur me fjalët se “ tani dhuna është e ndaluar dhe nxënësit kanë shumë liri, derisa para shumë viteve shkopi bënte punë”;
- d) Nxënësit raportojnë se gjatë një viti shkollor, ndodh që një mësimdhënës të ketë goditur apo rrahur një nxënës;
- e) Zënkat në mes të nxënësve janë problemet që janë raportuar më së shpeshti, por nuk mungojnë as zënkat në raportin nxënës – mësimdhënës;
- f) Një numër i konsiderueshëm i nxënësve shfaqet tolerant ndaj përdorimit të ndëshkimit fizik nga ana e mësimdhënësve;

Ndërkaq, sikur edhe në shkollat tjera, edhe në shkollën fillore “Sadullah Brestovci”, pjesëmarrja e nxënësve fillimisht është përcjellur me tendencën e stigmatizimit për listën e nxënësve. Në këtë shkollë, takimet individuale me nxënës në fillim kanë qenë më të mëdha në numër, ku brenda një ditë pune është punuar me më shumë se 10 nxënës individualisht. Në takimet individuale çështjet që janë diskutuar përvec që kanë marr formë konfidenciale, në parim kanë qenë të ndërlidhura me çasjen jo të mirë të menaxhimit të sjelljes, përkatësisht menaxhimit të zemërimit që nxënësit kanë raportuar. Për këtë problem nxënësit kanë marrë këshillat e nevojshme. Në kuadër të bashkëpunimit me mësimdhënës, drejtoria e shkollës ka dhënë rezultate të kënaqëshme në përfshirjen e nxënësve për të qenë të rregullt në çdo takim të mbajtur.

Çështja e formave të ndryshme sjelljeve të dhunshme, është debatuar edhe me prindërit e nxënësve të kësaj shkolle. Prindërit janë përgjigjur ftesës për takim dhe kanë raportuar të jenë mirënjohës për aktivitetet e realizuara me fëmijët e tyre dhe të njëjtin kanë raportuar të kenë vënë re ndryshimet e kënaqëshme në sjelljet e fëmijëve të tyre.

Numri i takimeve	Takimi 1	Takimi 2	Takimi 3	Takimi 4	Takimi 5	Takimi 6	Takimi 7	Takimi 8	Takimi 9	Takimi 10
Pjesëmarrja e nxënësve	13 nx.	4 nx.	13 nx.	8 nx	10 nx.	13 nx	9 nx	10 nx.	17 nx	15 nx
Datat:	2 prill	15 prill	22 prill	6 maj	14 maj	20 maj	3 tetor	6 tetor	13 tetor	20 tetor

**Tabela nr.4. Pjesëmarrja e nxenesve ne takime te regullta ne sh.f.m.u. "Sadullah Brestovci"**



Edhe në këtë shkollë, pjesëmarrja e nxënësve është rritur në takimet e mëvonshme, kur nxënësit e rregullt pjesëmarrës kanë reflektuar te nxënësit tjerë duke kontribuar në përmirësimin e besimit se takimet grupore kanë karakter trajtimi të nxënësve problematik.


Në këtë shkollë me sukses është realizuar takimi me prindërit dhe mësimdhënësit, duke reflektuar me një pjesëmarrje të lartë (27 pjesëmarrës) në takim për të debatuar dhunën në shkollë. Dy prej prindërve kanë kërkuar të kenë dhe takime individuale, gjë e cila është realizuar dhe prindërit kanë marrë këshilla për çasjen dhe trajtimin e vlerësimit të fëmijëve. Në këtë bashkëbisedim janë raportuar pakënaqësit e mëdha për mungesën e psikologut të shkollës duke theksuar rolin e rëndësishëm që mund të ketë psikologu në përmirësimin e sjelljes së nxënësve, raportit me mësimdhënësit, si dhe rëndësinë e trajtimit të rasteve të sjelljeve të dhunshme në shkollë.



Në shkollën fillore “Abdullah Tahiri”, pjesëmarrja e nxënësve në takimet e rregullta ka qenë më e kënaqëshme dhe nga vetë nxënësit është kërkuar që takimet e përbashkëta të jenë më shumë në numër dhe të jenë rregullta (së paku 1 takim në javë). Nxënësit kanë prekur vetë rezultatet \*rasti i elaboruar nga ilustrimi për takime individuale (shih pjesën e përshkruar në shembujt ilustrativ) duke krijuar kohezion në grup, përpjekje për të bashkëpunuar dhe kontribuar në diskutime për mundësit e parandalimit të dhunës në shkollë.

**Tabela nr.5. Pjesëmarrja e nxenesve ne takime grupore, shkolla fillore „Abdullah Tahiri “**

Numri i takimeve	Takimi 1	Takimi 2	Takimi 3	Takimi 4	Takimi 5	Takimi 6	Takimi 7	Takimi 8	Takimi 9	Takimi 10
Pjesëmarrja e nxënësve	9 nx.	19 nx.	22 nx.	24nx	24nx	25nx	25 nx	20nx	15 nx	19 nx
Datat:	30 mars	20 prill	7 maj	21 maj	22 qershor	21 shtator	28 shtator	5 tetor	12 tetor	19 tetor




Në shkollën fillore “Esat Berisha”, nxënësit janë mbështetur shumë nga drejtori i cili ju është përgjigjur kërkesave të nxënësve për bashkëpunim. Drejtorja e shkollës, nxënësve u është përgjigjur kur kanë kërkuar (hulumtuar) shënime për numrin e nxënësve, numrin e rasteve të dhunës të paraqitura në shkollë, për numrin e mungesave dhe për çështje tjera, shënime këto të cilat nxënësit i kanë përgatitur në punimet e tyre me karakter të prezantimit të shkollës dhe problemeve të dhunës në shkollë. Krahas

shkollave tjera të përfshira, takimet individuale me nxënës kanë qenë në numër më të vogël edhe pse takimet që janë realizuar kanë vazhduar më gjatë në shumë takime individuale me nxënësit e caktuar.

Bashkëpunimi i prindërve me shkollën është i nivelit të ulët. Në këtë shkollë prindërit nuk janë të rregullt në shkollë për të marrë informatat rreth ecurisë së planit edukativ-arsimior dhe duke përgjegjësinë për fëmijët e tyre në shkollë në organet drejtuese të shkollës. Ftesës për debat, prindërit i janë përgjigjur më pak, mirëpo nuk ka munguar përfaqësuesi i këshillit të prindërve. Nga ky takim është vënë në pah vështirësia që nxënësit mund të kenë nga mungesa e profesionistëve në trajtimin e sjelljes agresive të nxënësve, sjelljes fyese në raport mësimdhënës - nxënës.

**Tabela nr.6. Pjesëmarrja e nxenesve ne takimet grupore, shkolla fillore „ Esat Berisha“ – Llashtice**

Numri i takimeve	Takimi 1	Takimi 2	Takimi 3	Takimi 4	Takimi 5	Takimi 6	Takimi 7	Takimi 8	Takimi 9	Takimi 10
Pjesëmarrja e nxënësve	18 nx	18	18	18	15	15	25	9	24	21
Datat:	30 mars	14 prill	24 prill	15 maj	18 maj	4 qershor	19 qershor	14 shtator	28 shtator	5 tetor



Në këtë shkollë, gjithashtu theksohet edhe vullneti i nxënësve për t’i trajtuar problemet dhe vështirësitë në takime individuale, prej të cilëve 8 nxënës kanë përfituar nga keto takime.

## **Prezantimi i pjesëmarrjes së nxënësve për dy(2) shkollat e mesme të pilotuara**

### **Shkolla Mesme Ekonomike „Marin Barleti“ dhe Shkolla Mesme Teknike „Mehmet Isai“**


Te shkollat e mesme të përzgjedhura, nxënësit kanë qenë më pak të rregullt dhe kanë rrezistuar më gjatë ndaj kërkesës për t’u formuar si grupe. Drejtorja e shkollës, përkatësisht zëvendës drejtori i shkollës së mesme ekonomike në vazhdimësi ka përcjellur takimet grupore të nxënësve, mirëpo edhe në



këtë shkollë pjesëmarrja e nxënësve ka ndryshuar nga fillimi, derisa është kuptuar dhe janë vendosur qëllimet e takimeve duke u qartësuar përmbajtja e takimeve. Nxënësit kanë arritur që me dëshirë të vijnë takimet duke e përmirësuar edhe bashkëpunimin midis tyre. Disa nga pjesëmarrësit kanë reportuar të kenë marrë iniciativë të shpërndajnë njohuritë e fituara nga takimet në grup me nxënësit e klasëve nga ata vijnë dhe duke aplikuar dhe teknikat e relaksimit në rrethin e tyre shoqëror.

**Tabela nr. 7. Pjesëmarrja e nxënësve në takime grupore, Shkolla e Mesme Ekonomike „Marin Barleti“**


Numri i takimeve	Takimi 1	Takimi 2	Takimi 3	Takimi 4	Takimi 5	Takimi 6	Takimi 7	Takimi 8	Takimi 9	Takimi 10	Takimi 11
Pjesëmarrja e nxënësve	10 nx.	17.nx.	17	11nx.	12 nx	22 nx.	11 nx	24nx.	17 nx	18 nx	18 nx
Datat:	1 prill	15 prill	17 prill	13 maj	22 prill	21 maj	5 qershor	18 shtator	21 shtator	23 shtator	14 tetor



Nxënësit kanë arritur të bashkëpunojnë në mes vete dhe nëpërmjet punimeve kanë prezantuar format e parandalimit të sjelljeve të dhunshme në shkollë midis bashkëmoshatarëve, në raportin nxënës – mësimsdhënës, duke dhënë dhe rekomandimet konkrete për parandalimin e sjelljeve agresive dhe të dhunshme në shkollë.

**Tabela nr. 8. Pjesëmarrja e nxënësve në takimet grupore në Shkollën e Mesme Teknike “Mehmet Isai”**

Numri i takimeve	Takimi 1	Takimi 2	Takimi 3	Takimi 4	Takimi 5	Takimi 6	Takimi 7	Takimi 8	Takimi 9	Takimi 10
Pjesëmarrja e nxënësve	13 nx.	4 nx.	13 nx.	8 nx	10 nx.	13 nx	9 nx	10 nx.	17 nx	15 nx
Datat:	1 prill	14 prill	21 prill	5 maj	23 maj	5 shtator	12 shtator	19 shtator	12 tetor	19 tetor



Mund të thuhet se nxënësit e shkollave të mesme përkundër që kanë vijuar takimet në grupe, kanë raportuar të jenë me vullnetin e mire dhe të vazhdojnë të jenë pjesë e takimeve të tilla të organizuara në të cilat mund të flasin lirshëm dhe të nxjerrin në pah dilemat, pakënaqësitë me të cilat përballen.

### Prezantimi i pjesëmarrjes së prindërve dhe mësimeve

Takimi i planifikuar të mbahet me mësime dhe prindër, nuk është mbajtur në shkollat e mesme. Mësime kanë treguar një vullnet më të ulët për të qenë për kohë më të gjatë në raport bashkëpunues me nxënësit, në kuptimin e përcjelljes së aktiviteteve në kohë më të gjatë. Megjithatë, me pak presion të kohës, në shkollën e mesme teknike është realizuar takimi me mësime duke qenë të pranishëm 15 mësues, disa prej të cilëve kishin kureshtje fillimisht të informohen në përgjithësi mirëpo lëviznin duke lënë në gjysmë takimin. Dhe, bazuar në këto rrethana të krijuara, takimi mori karakter vetëm informues edhe pse kjo pjesë është realizuar në fillim të realizimit të projektit.



Takimet e realizuara me mësime dhe prindër

Prinderit e femijeve te perzgjedhur per takime grupore, permes shkreses informuese jane njoftuar per projektin dhe aktivitetet qe do te realizohen me femijet e tyre ne shkolle permes punetorive.

Duke krahasuar pjesmarrjen e prinderve ne shkollat fillore dhe te mesme, mund te theksohet se prinderit e nxenesve ne shkollat e mesme nuk i jane pergjigjur fteses per takime per dallim nga prinderit e nxenesve ne shkollat fillore. Perkunder qe pjesmarrja e prinderve nuk ka qene ne nivelin e pritshem apo ne nivel te kenaqshem, megjithate prinderit ne shkollen fillore Selami Hallaqi, Sadullah Brestovci, Abdullah Tahiri kane qene te pranishem duke dhene dhe kontributin edhe individual ne diskutim per ceshtjen e dhunes ne shkolle, manifestimit te nivelit te sjelljeve agresive apo edhe te dhunshme te femijeve te tyre. Perkunder qe, ne shkollen fillore Esat Berisha ne takim ka qene i pranishem vetem perfaqesuesi i prinderve(kryetari i keshillit te prinderve).

Ndërës, mësimdhënësit e shkollave fillore; Selami Hallaqi, Esat Berisha, Abdullah Tahiri, Sadullah Brestovci i janë përgjigjur ftesës duke qenë pjesmarrës në fokus grupe kur edhe janë diskutuar rastet problematike me nxënës, sjellja e tyre, veshtërsive në punë me nxënës dhe format e parandalimit të sjelljeve të dhunshme e dhunës në shkollat përkatëse. Me mësimdhënësit e shkollës së mesme teknike Mehmet Isai, gjithashtu është realizuar takimi i parë informues për projektin dhe aktivitetet të cilat do të punohen me nxënës si dhe debati i realizuar në shkollë, duke diskutuar çështjen e dhunës në shkollë.

Në takimet e lartëshënuara, pjesmarrësit kanë raportuar të jenë mirënjohës për përkushtimin dhe nevojën e casjes së drejtpërdrejtë në punë me nxënës. Është theksuar e domosdoshme vazhdimësia e programeve të tilla me fokus në qendër nxënësin dhe casjes bashkëpunuese me prindër e mësimdhënësve që si i tillë programi do të duhej të jetë i aplikueshëm për të gjitha shkollat.

Prinderit e femijeve te referuar per takime individuale pervec qe kane qene te njoftuar permes shkreses, disa prej tyre kane kerkuar te realizojne dhe takim individual me eksprertet ne shkollat perkatese. Nga disa prej prinderve jane pranuar dhe informacionet kthyes per arritjet dhe ndryshimet e sjelljes se femijeve te tyre si rezultat i punes individuale me nxenes.

## **Punëtori me nxënësit e gjitha shkollave pilot**

Një punëtori përmblylësë për nxënësit e të gjitha shkollave të selektuara ka qenë i përbashkët, ku është debatuar për format e dhunës, shenjat e identifikimit të hershëm të sjelljeve agresive të cilat do të mund të nxisin sjelljet e dhunshme në shkolla. Nxënësit nga të gjitha shkollat e pilotuara kanë përgatitur në nëngrupe punime të ndryshme në të cilat kanë pasqyruar opinionet e tyre për dukurinë e dhunës në shkolla në përgjithësi duke përmendur dhe raste konkrete konfliktuozë të cilat ndodhin në shkollë. Në punëtori, është adresuar edhe çështja e formave të parandalimit të sjelljeve agresive dhe të dhunshme në shkolla, ku secili grup nxënësish të cilët kanë përfaqësuar shkollat prej nga vijnë, kanë reflektuar mbi format e sjelljes agresive dhe të dhunshme në shkollë. Është diskutuar në mënyrë të vecant edhe sistemi i referimit të dhunës në shkolla duke përmendur fillimisht hierarkinë e shkollës (rregullave e brendshme në shkollë), akterët përgjegjës për të trajtuar sjelljen problematike, agresive dhe të dhunshme në shkollë. Janë përmendur nxënësit me predispozitë për të qenë të dhunshëm duke specifikuar shenjat e identifikimit të hershëm dhe raportet ndërmjet mësimdhënësve – nxënësve e anasjelltas dhe bashkëpunimi me prindërit si një prej faktorëve të rëndësishëm për të parandaluar sjelljet dhe veprimet e dhunshme në shkollë.



**Prezantimi i pjesmarrjes së punëtorisë përmblylësë me nxënës**

## Prezantimi i takimeve individuale të realizuara me nxënës

Rastet e punuara individuale, kanë rezultuar të jenë të suksesshme, duke theksuar shembuj të caktuar të cilët kanë referuar ndryshime të kenaqshme për vetë nxënësit, mësime dhe familjarët e tyre. Për takimet individuale mund të theksohen rastet e suksesshme në shkollat fillore, duke përmendur si në vijim:

a) Dy nga nxënëset e klasës IX të shkollës fillore “Abdullah Tahiri”, kanë qenë të përfshira në konflikt fizik mes vete paraprakisht. Dhe, nga takimet e rregullta me pjesëmarrje në grupe, nxënëset kanë arritur të evitojnë konfliktin fizik mes vete dhe njëkohësisht kanë arritur të bashkëpunojnë mes vete si dy nga lideret në klasë nga ato vijnë duke promovuar dhe shpërndarë njohurit e mësuara për menaxhimin e zemërimit, sjelljeve agresive dhe të dhunshme në shkollë. Nxënëset e lartpërmendura fillimisht kanë vijuar në takime individuale duke vazhduar me takime të rregullta në grup.

b) Nxënësi nga shkolla fillore “Thimi Mitko” i cili nga takimet individuale ka arritur të mësojë të menaxhojë zemërimin duke aplikuar edhe format e relaksimit të mësuara. I njëjti i cili më parë kishte bartë herë pas herë dhe armë të ftohta në shkollë, ka arritur që të eliminojë bartjen e armëve duke filluar të mendojë dhe për orientim profesional, duke cituar: “ nuk do të ushtrohem më për boks, por kam filluar të mësojë më shumë dhe më gjatë që të përgatitem për regjistrim në gjimnaz si një mundësi për t’u orientuar në studime shkencore”. Për këtë rast, familja e nxënësit gjithashtu është mirënjohëse për ndryshimet pozitive që nëna e tij thekson se janë të dukshme në sjelljen e tij.(shih letrën falenderuese të shkruar nga nëna: bashkangjitur)

c) Nxënësi nga shkolla e mesme ekonomike “Marin Barleti”, nga takimet individuale ka rezultuar të ketë sukses duke e përmirësuar vijueshmërinë e tij në shkollë, gjithashtu duke e minimizuar mundësinë e përfshirjes së tij në konflikte fizike me një grup nxënësish nga shkollat e mesme teknike. Ajo që duhet përmendur në këtë rast është rezultati që nxënësit nga të dyja shkollat kanë filluar të përmirësojnë raportet mes vete, veçanërisht nga punëtorja e përbashkët e mbajtur me nxënësit e të gjitha shkollave të pilotuara.

## Rekomandimet

Duke theksuar rëndësinë e shoqërimit, ku rrethi shoqëror ka fuqinë e influencës më të madhe në këtë periudhë të zhvillimit, është diskutuar për mundësi të reja bashkëpunimi e bashkëveprimi për aktivitete midis nxënësve, për të diskutuar hapur dhe me mësimdhënësit, drejtoritë e shkollave ku nxënësit e konsiderojnë të vlefshme përfshirjen e personelit të shkollës. Nxënësit nuk janë rezervuar edhe në paraqitjen e programeve të cilat do të ndihmonin në zhvillimin e vet fëmijëve me karakter vlerësimi të tyre si resurs i çdo shkolle ku nxënësit janë.

Për të vepruar në parandalim të dhunës dhe rasteve të dhunshme në shkolla, duhet që;

- a) Në shkollat fillore dhe të mesme të punësohen psikolog;
- b) Shkollat të funksionalizojnë këshillat e shkollave;
- c) Shkollat të krijojnë hapësirë për punë me nxënës;
- d) Nxënësit e të gjitha shkollave të hartojnë rregullat e sjelljes, rregullat me etikë që duhet respektuar nga të gjithë pa dallim;
- e) Nxënësit të shprehen lirshëm dhe këshillohen për veprimet e dobishme apo edhe të dëmshme për ta;
- f) Veprimet e dhunshme të dënohen për të gjithë pa dallim;
- g) Kutitë e opinioneve për vlerësim të sjelljeve të mësimdhënësve të vendosen në hapësira, çasja ndaj të cilave është e dukshme dhe e lehtë për nxënësit për të diskutuar më vonë çasjet jo të përshtatshme nga mësimdhënësit të raportuara nga nxënësit e pidentifikuar;
- h) Nxënësit të raportojnë drejtëpërdrejt për rastet e sjelljes fyese dhe ofenduese;
- i) Të punohet në funksionalizimin e trekëndëshit pedagogjik ( të përmirësohet raporti mësimdhënës – nxënës - prindër);

Adresa më e sigurt për shumicën e prindërve dhe mësimdhënësve për të raportuar kërcënimet që mund të kenë në shkollë janë kujdestari i klasës dhe drejtori i shkollës.

➤ Mësimdhënësit pohojnë se masën më të shpeshtë që e përdorin për të mbajtur disiplinën në klasë është dënimi verbal dhe njoftimi i prindërve në rast se fëmija performon ndonjë sjellje që është kundër rregullave dhe kodeve të shkollës;

➤ sjelljet e nxënësve që bien ndesh me rregulloren e shkollës janë të larta

Çështja e menaxhimit të zemërimit është theksuar të jetë në interes dhe lehë e pranueshme për nxënësit të pranishëm në grupe. Teknikat e relaksimit të mësuara në takimet e rregullta, gjithashtu janë vlerësuar të jenë atraktive për vetë nxënësit dhe që mund t'u shërbejnë gjithmonë në situata të stresit, shqetësuese mëtutje. Perspektiva individuale ndaj dhunës, formave dhe manifestimit të saj janë nga më

të ndryshme dhe interesante për vetë nxënësit, duke qenë njëkohësisht dhe një mundësi e mirë për të mësuarit e strategjive të ndryshme të reagimit dhe ballafaqimit me dhunën.

Përfundimisht, nxënësit, mësime dhënësit dhe prindërit pajtohen që infrastruktura shkollore ka nevojë për intervenim. Gjithashtu, sipas tyre, për të sjellë në nivel të mirë funksionimin e trekëndëshit nxënës-prind-mësime dhënësit, nevojitet funksionimi i këshillave profesionale dhe nga të gjithë përfituesit e lartëshënuar mund të konstatohet e domosdoshme punësimi i psikologevë në shkolla si një nga adresat e sigurta për të adresuar çështjet problematike me të cilat ballafaqohen nxënësit ne veçanti. Mirëpo, kërkesa për këshillim profesional nga psikologu në shkollë është rekomandim edhe nga vetë drejtoritë e shkollave dhe mësime dhënësit.